



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 83-të të mbajtur më 27.03.2023 ka miratuar

### **Vendim**

Procedura për lëndën me nr. 08-3921/ 1 datë 09.10.2021, NDËRPRITET.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3921/1 datë 09.10.2021.

Lënda me numër 08 –3921/1 të datës 09.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### **Arsyetim**

Lënda me numër 08-3921/1 datë 09.10.2021 është formuar me vetiniciativë.

Nga këqyrja e kryer në evidencën e saj, KSHPK-ja konstaton se personi \_\_\_\_\_ në afatin ligjor prej 30 ditësh pas përfundimit të pozitës anëtar i Bordit Drejtues -----, nuk ka dorëzuar fletë anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

KSHPK-ja përpiloi procesverbal për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit \_\_\_\_\_.

Duke qenë se personi \_\_\_\_\_ nuk ka vepruar sipas urdhërpagesës kundërvajtëse brenda afatit të përcaktuar ligjor, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse pranë komisionit kundërvajtës në KSHPK.

Komisioni për kundërvajtje në KSHPK me Vendimin nr. 14-5564/5 datë 03.08.2022 shpalli \_\_\_\_\_ përgjegjës për veprën kundërvajtëse nga neni 82 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, të dënueshme sipas nenit 109 të të njëjtit ligj dhe i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje me gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë në denarë.

Duke pasur parasysh tē theksuarēn e mēsipērme, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vendosi si nē dispozitēn e kētij vendimi.

Pērgatiti: Mr. Antonija A. Tasevska  
Miratoi: Vladimir Georgiev, anētār

**KOMISIONI SHTETĒROR  
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
NĒNKRYETAR,  
Katica Nikolovska**

